

Fjala e bukur*

Fjalë quhet zëri ose zërat e kuptimtë që, me ndihmën e tonit e të gjuhës, rrjedhin përmes dy buzëve tona pasi t'i kemi projektuar në kokë, pasi t'i kemi miratuar me zemër dhe pasi të kemi përcaktuar qëllimin e tyre.¹ Sipas kësaj, fjala është elementi më themelor dhe më i vogël i aftësisë së të folurit që na ka dhuruar Zoti. Fjala është gjuha e trurit dhe e zemrës sonë, është rruga e shprehjes së qëllimeve dhe dëshirave tona. Paqartësinë e mendimeve, të qëndrimeve dhe të veprimeve tona e bëjmë të dukshme, të kuptueshme dhe të qartë nëpërmjet fjalës.

Fjala mund të jetë një rrëfim që e tregon të kaluarën, mund të jetë një deklaratë që e shpreh të tanishmen, por mund të jetë edhe një premtim për në të ardhmen. Kjo e fundit pastaj shkakton përgjegjësi. Mbasi fjala për njeriun është rruga më e pashmangshme për ta treguar vetveten, ajo njëkohësisht është edhe fryma që ndjehet brendapërbrenda trupit të dukshëm të njeriut dhe personaliteti i tij që formësohet në të. Ashtu siç theksohet edhe në parimin juridik: *“Përderisa nuk dëshmohet e kundërta, për bazë merret deklarata personale e njeriut”*, fjala është në fakt vetë njeriu. Fjala, në qoftë se është e drejtë, shpreh drejtësinë e personit që e thotë, po në qoftë se nuk është e drejtë, në qoftë se është e rreme, shpreh gënjeshtëri e tij ose madje edhe e kamuflon atë. Fjala dallon nga llafi, që kryesisht nënkupton llomotitjen, fjalët e kota dhe boshe, zhurmën e thatë. Ndërkaq fjala është emri i përbashkët i fjalëve që kanë kuptim, thellësi dhe vlerë.

Drejtësia dhe korrektësia në fjalë është kusht themelor, ndërkaq bukuria është shkak i përzgjedhjes. Secili njeri ndoshta nuk është i aftë dhe i zoti të thotë fjalë të bukura, mirëpo secili është i obliguar të thotë fjalë të drejta e të vërteta. Po kështu, secili njeri ndjen kënaqësi kur e dëgjon fjalën e drejtë dhe të bukur. Bile, bile edhe ai që rrenën e ka bërë zanat të tijin dhe i cili rrenat i merr për të vërteta ose të vërtetat për rrena, ka dëshirë dhe priret të dëgjojë fjalë të drejta e të vërteta. Në fjalën e rreme ka mashtrim dhe pabesi. Kur një fjalë merret vesh se është e rreme dhe kur dëgjuësit e saj kuptojnë se janë mashtruar, ata preken thellë dhe ndihen të ofenduar. Mirëpo pastaj edhe rrenacakun e nxjerrin nga lista e njerëzve të ndershëm. Rrenacaku, me situatat e rreme dhe jo të vërteta, para se t'i mashtrojë të tjerët, e ka mashtruar vetveten. Për këtë arsye, të keqen dhe paturpësinë më të madhe rrenacaku në fakt ia bën vetvetes.

Fjala mbinë dhe rritet në kopshtin e zemrës, zihet e piqet në kuzhinën e trurit dhe gostitet në kuvendin e miqve të ndershëm. Lezeti apo shija e fjalës varet nga zengjijnllëku dhe sinqeriteti i

* Artikulli origjinal i autorit “Sözün güzeli” është botuar në revistën e përmuajshme të Dijanetit të Turqisë për Evropën, në dhjetor 2002, nr. 44, f. 43-45.

¹ Në Fjalorin e Shqipësisë së Sotme termi *fjalë* përkufizohet kështu: *“Njësia e mëvetëshme më e vogël e gjuhës, tërësi e pandashme e tingëllimit dhe e kuptimit e formësuar nga ana gramatikore, që pasqyron në mënyrë të përgjithësuar e shënon sende e dukuri të realitetit dhe riprodhohet e veçohet në rrjedhën e ligjëritimit.”* Fjalor i Shqipërisë së Sotme, Akademia e Shkencave e Shqipërisë – Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Botimet Toena, Tiranë 2002, zëri “fjalë/a” – shën. i përkthyesit.

zemrës. Cakun që dëshiron ta arrijë njeriu nëpërmjet fjalës, në fakt është nijeti apo qëllimi drejt të cilit është orientuar zemra. Në qoftë se caku i fjalës dhe nijeti i zemrës janë të njëjtë, atëherë ajo fjalë është e vërtetë; në qoftë se karakteri i fjalës është i arsyeshëm dhe i ligjshëm, atëherë ajo fjalë është e drejtë; në qoftë se shprehja dhe stili i fjalës i jep hare dhe kënaqësi dëgjuesit të saj, atëherë ajo fjalë është e bukur.

Aristoteli kështu e përkufizon fjalën e mirë: *“Fjala më e mirë është ajo të cilën folësi i saj e thotë drejtë, kurse dëgjuesi ka dobi prej saj”*. D.m.th. për të qenë një fjalë e mirë, ajo duhet të jetë edhe e dobishme. Një fjalë mund të jetë e hidhur, mirëpo nuk guxon të jetë e gabuar, jo e drejtë. Për ta shprehur një ngjarje të dhimbshme fillimisht mund të heqim dorë nga bukuria e fjalës, më pastaj në qoftë se ka nevojë edhe nga vërtetësia e saj (siç është rasti ku mund të lejohet rrena). Mirëpo kurrë nuk hiqet dorë nga drejtësia dhe korrektësia e fjalës.

Edhe pse thuhet se *“fjala fluturon, ndërsa shkrimi mbetet”*, një besimtar që e lexon Kur’anin e di mirë se një pjesë e fjalës mund të fshihet nga kujtesa e njerëzve, mirëpo çdo pikë a presje e fjalëve shënohet në regjistrin personal të veprave të tij:

إِذْ يَتَلَفَّى الْمُتَلَفِّيَانِ عَنِ الْيَمِينِ وَعَنِ الشِّمَالِ قَعِيدٌ ﴿١٧﴾ مَا يَلْفِظُ مِنْ قَوْلٍ إِلَّا لَدَيْهِ رَقِيبٌ عَتِيدٌ ﴿١٨﴾

“Dhe se kur dy engjëjt qëndrojnë pranë tij në të djathtë dhe në të majtë. Që ai nuk hedh ndonjë fjalë e të mos jetë pranë tij përcjellësi i gatshëm.” (Kaf, 50:17-18).

Ashtu siç do të jepet llogari për veprat, po ashtu do të jepet llogari edhe për fjalët. Për këtë arsye, duhet që të folurit, si një veprim që secili njeri dhe për çdo ditë e bën në mënyrë të pavetëdijshme, të jetë i drejtë dhe i bukur. Njerëzit priten sipas teshave që kanë veshur, ndërkaq gostiten dhe përcillen sipas muhabetit që bëjnë. Për ta ruajtur dhe lartësuar nderin dhe dinjitetin tonë kemi nevojë për fjalë të drejta e të bukura, po aq sa në këtë botë kemi nevojë për bukë e ujë.

Fjala e mirë dhe e bukur në Kur’an

Sipas besimit tonë islam që kemi, Kur’ani fisnik si një fjalë e Zotit është më e drejta dhe më e bukura. Sipas Kur’anit fisnik, fjala më e dëlirë dhe më e bukur është fjala e *imanit* (besimit), pra e dëshmisë se nuk ka zot tjetër pos All-llahut xh.sh. dhe se Muhammedi a.s. është i Dërguar i tij:

يُثَبِّتُ اللَّهُ الَّذِينَ آمَنُوا بِالْقَوْلِ الثَّابِتِ فِي الْحَيَاةِ الدُّنْيَا وَفِي الْآخِرَةِ ... ﴿٢٧﴾

“All-llahu forcon ata që besuan në fjalën e fortë (të mirë) në jetën e kësaj bote e edhe në botën tjetër...” (Ibrahim, 14:27).

Fjalën e bukur All-llahu xh.sh. në Kur’an e paraqet me këtë krahasim apo alegori:

أَمْ تَرَ كَيْفَ ضَرَبَ اللَّهُ مَثَلًا كَلِمَةً طَيِّبَةً كَشَجَرَةٍ طَيِّبَةٍ أَصْلُهَا ثَابِتٌ وَفَرْعُهَا فِي السَّمَاءِ ﴿٢٤﴾ تُؤْتِي أُكْلَهَا كُلَّ حِينٍ بِإِذْنِ رَبِّهَا وَيَضْرِبُ اللَّهُ الْأَمْثَالَ لِلنَّاسِ لَعَلَّهُمْ يَتَذَكَّرُونَ ﴿٢٥﴾ وَمَثَلُ كَلِمَةٍ خَبِيثَةٍ كَشَجَرَةٍ خَبِيثَةٍ اجْتُثَّتْ مِنْ فَوْقِ الْأَرْضِ مَا لَهَا مِنْ قَرَارٍ ﴿٢٦﴾

“A nuk e sheh se All-llahu sjell shembull fjalën e mirë sikur pemën e mirë, rrënja e së cilës është e ngulitur fort, kurse degët i ka kah qielli. Me leje të Zotit të vet i jep frytet e veta në çdo kohë – dhe

All-llahu u sjell shembuj njerëzve, ndoshta do të mendojnë. Fjala e shëmtuar është si pema e shëmtuar: e shembur për dhé dhe e paqëndrueshme për ekzistencë.” (Ibrahim, 14: 24-26)

Në këto ajete fjala e drejtë dhe e bukur përngjanë si një pemë me rrënjë të forta e me fruta të shumta, që për ne tregon se fjala ka dy veçori kryesore:

- Fjala, ashtu si rrënjët e pemës, duhet të jetë e mbështetur, e qëndrueshme dhe e dëshmuar,
- Fjala, ashtu si frutat e pemës, duhet të jetë e dobishme për atë që e dëgjon.

Fjala (*kelimeh*) shënon çdo deklaratë ose pohim konceptual. Sipas kësaj, një “fjalë e mirë” nënkupton çfarëdo një pohim (ose ide) që në qenësinë e tij është i vërtetë dhe – meqë ai implikon një ftesë për atë që është e mirë në kuptimin moral – është përfundimisht edhe i dobishëm dhe i qëndrueshëm; dhe meqë ftesa për drejtësi morale është qëllimi më i thellë dhe më i brendshëm i secilit mesazh të Zotit, termi “fjala e mirë” vlen edhe për të gjitha ato (mesazhe). Po kështu, edhe “fjala e shëmtuar” që përmendet në ajetin 26 shënon të kundërtën e asaj që ka për qëllim një mesazh hyjnor, pra shënon çdo ide që për nga qenësia e saj është e pavërtetë, që për nga aspekti moral është e keqe dhe, përfundimisht, që për nga aspekti shpirtëror është e dëmshme.²

All-llahu xh.sh. kërkon prej besimtarëve ta flasin të drejtën:

يَا أَيُّهَا الَّذِينَ آمَنُوا اتَّقُوا اللَّهَ وَقُولُوا قَوْلًا سَدِيدًا ﴿٧٠﴾

“O besimtarë, druheni Perëndisë dhe thoni vetëm fjalën e vërtetë!” (Ahzab, 33:70).³

Termi “*kaul sedid*” që përmendet në ajet fjalë për fjale shënon “një të thënë që e godet cakun”, pra që është e vërtetë, relevante dhe me vend, larg çdo kuptimi e insinuate të fshehtë, larg çdo dyshimi të pavlerë, që ka për synim as më shumë e as më pak se të vërtetën.⁴

Se kush janë ata që flasin bukur, këtë na e thotë ajeti në vazhdim:

وَمَنْ أَحْسَنُ قَوْلًا مِّمَّنْ دَعَا إِلَى اللَّهِ وَعَمِلَ صَالِحًا وَقَالَ إِنَّنِي مِنَ الْمُسْلِمِينَ ﴿٣٣﴾

“E, kush flet më bukur se ai që thërret te Perëndia, bën vepra të mira dhe thotë: ‘Unë, me të vërtetë, jam musliman!’?” (Fussilet, 41:33)

Në këtë ajet kur’anor flitet për tri kategori të njerëzve që janë fjalëbukur: i pari, ai që e thotë të vërtetën duke i ftuar të tjerët në Islam; i dyti, ai që punën e tij e bën të plotë, precize, bukur dhe si duhet*; i treti, ai që mban qëndrim dinjitoz. Për ata që nuk e flasin të drejtën dhe të mirën, All-llahu xh.sh. tërheq vërejtjen:

وَقُلْ لِعِبَادِي يَقُولُوا الَّتِي هِيَ أَحْسَنُ إِنَّ الشَّيْطَانَ يَنْزِعُ بَيْنَهُمْ إِنَّ الشَّيْطَانَ كَانَ لِلْإِنْسَانِ عَدُوًّا مُّبِينًا ﴿٥٣﴾

“Thuaju robërve të Mi, le të flasin atë që është më e bukur. Me të vërtetë, djalli mbjell ngatërresa në mes tyre. Me të vërtetë, djalli është armik i hapët i njeriut.” (el-Isra’, 17:53).

² Muhammad Asad, *The Message of the Qur’an*, Dar al-Andalus Limited, Gjibraltar 1980, fusnota 36 e ajetit 24, f. 475-476.

³ Po ashtu edhe në en-Nisa’, 4:9: “... le t’i druhen Perëndisë dhe le të flasin drejt!”.

⁴ M. Asad, po aty, fusnota 86 e ajetit 70 të sures 33.

* Termi “*amel salih*” (vepër e mirë) në kuptimin më të thjeshtë nënkupton kryerjen e një pune me sinqeritet, në mënyrë të drejtë dhe ashtu siç e lyp rendi.

Një ndër metodat e shumta të *da'vetit* (ftesës në Islam) që All-llahu xh.sh. ia ka mësuar Muhammedit a.s. është edhe “këshilla e bukur”.⁵ Këshilla e mirë nënkupton prezantimin e bukur të së vërtetës, përdorimin e një metode konstruktive, dinjitoze dhe shpresëdhënëse me rastin e bindjes së bashkëbiseduesit, edhe sikur të mos bindet ai, së paku të krijohet një dialog i hapur dhe respektues ndaj kësaj mundësie apo alternative për të. Kjo nënkupton pikërisht përdorimin e metodës që na këshillon Muhammedi a.s. kur thotë:

يَسِّرُوا وَلَا تُعَسِّرُوا وَبَشِّرُوا وَلَا تُنْفِرُوا!

“Lehtësoni e mos vështirësoni! Përgëzoni e mos trembni!” (Buhariu dhe Muslimi)

Kjo këshillë luan rol shumë të rëndësishëm në përdorimin e fjalës së mirë e të bukur.

Rëndësia e fjalës së mirë në Sunnet

Muhammedi a.s. ishte njeriu më elokuent (gojëtar), më i rrjedhshëm dhe në të njëjtën kohë më fjalë-drejtë në mesin e arabëve. Ai edhe para se të shpallej nga Zoti për pejgamber, në saje të fjalëve të sakta dhe në saje të drejtësisë në vepër, atij ia dhanë ofiqin *el-Emin* (besnik, i drejtë). Një veti tjetër e tij ishte edhe *xhevami’ul-kelim* (i thukët, i ngjeshur, me pak fjalë e me kuptime të thella).⁶ Ai i jepte rëndësi të madhe çështjes së fjalimit të drejtë e të bukur në hadithet e tij që i thoshte për ta sqaruar Kur’anin, për t’i edukuar, mësuar dhe udhëzuar njerëzit. Ai e ka lidhur të folurit e drejtë me vetë *imanin* (besimin) dhe ka theksuar se edhe rrena edhe besimi nuk mund të kenë vend të përbashkët dhe se ata që besojnë All-llahun xh.sh. dhe ditën e Gjykimit duhet të flasin ose drejtë ose të heshtin.

مَنْ كَانَ يُؤْمِنُ بِاللَّهِ وَالْيَوْمِ الْآخِرِ فَلْيُكَلِّمْ خَيْرًا أَوْ لِيَصْمُتْ!

“Kush beson All-llahun dhe Ditën e Gjykimit, ose le të flasë mirë ose le të heshtë!”⁷

Të folurit e mirë, i përfshinë edhe fjalët e drejta po edhe ato të bukura. Duke qenë se vetë Muhammedi a.s. ishte fjalë-mirë, fjalë-drejtë e fjalë-bukur, në këtë drejtim ai ka thënë:

مِنْ حُسْنِ إِسْلَامِ الْمَرْءِ تَرْكُهُ مَا لَا يَعْنِيهِ.

“Nga Islami i mirë i një njeriu është largimi nga ajo që nuk i intereson”.⁸

اتَّقُوا النَّارَ وَلَوْ بِشِقِّ تَمْرَةٍ فَإِنْ لَمْ تَجِدْ فَبِكَلِمَةٍ طَيِّبَةٍ!

“Ruaju nga zjarri i xhehennemit, qoftë edhe duke dhënë sadaka një gjysmë hurme. Në mos e paç edhe këtë, atëherë thuaje një fjalë të mirë”.⁹

الْكَلِمَةُ الطَّيِّبَةُ صَدَقَةٌ.

“Fjala e mirë është sadaka (lëmoshë)”.¹⁰

⁵ “Thirri në rrugën e Zotit tënd me mençuri dhe këshillë të bukur...” (en-Nahl, 16:125).

⁶ Buhariu, Xhihad, 122.

⁷ Buhariu, Edeb, 5672; Muslimi, Iman, 47.

⁸ Neveviu, 40 hadithe, nr. 12.

⁹ Buhariu, Edeb, 5677.

¹⁰ Muslimi, Zekah, 1683.

عَلَيْكُمْ بِالصِّدْقِ، فَإِنَّ الصِّدْقَ يَهْدِي إِلَى الْبِرِّ، وَإِنَّ الْبِرَّ يَهْدِي إِلَى الْجَنَّةِ، وَمَا يَزَالُ الرَّجُلُ يَصْدُقُ، وَيَتَحَرَّى الصِّدْقَ حَتَّى يُكْتَبَ عِنْدَ اللَّهِ صِدِّيقًا. وَإِيَّاكُمْ وَالْكَذِبَ، فَإِنَّ الْكَذِبَ يَهْدِي إِلَى الْفُجُورِ، وَإِنَّ الْفُجُورَ يَهْدِي إِلَى النَّارِ، وَمَا يَزَالُ الرَّجُلُ يَكْذِبُ، وَيَتَحَرَّى الْكَذِبَ حَتَّى يُكْتَبَ عِنْدَ اللَّهِ كَذَّابًا.

*“Përmbahuni drejtësisë dhe korrektësisë, sepse ajo të çon në mirësi, kurse mirësia të çon në xhenet. Përderisa njeriu është i drejtë dhe kapet pas korrektësisë, te All-llahu do të numërohet si i drejtë. Kini kujdes nga rrena, sepse ajo të çon në mëkat, mosbindje, dhe mosbindja të çon në xhehennem. Përderisa njeriu rren dhe kapet pas rrenës, te All-llahu do të numërohet rrenacak”.*¹¹

الْمُسْلِمُ مَنْ سَلِمَ الْمُسْلِمُونَ مِنْ لِسَانِهِ وَيَدِهِ...

*“Musliman (i vërtetë) është ai prej gjuhës dhe dorës së të cilit muslimanët (njerëzit tjerë) janë të sigurt”.*¹²

إِذَا أَصْبَحَ ابْنُ آدَمَ فَإِنَّ الْأَعْضَاءَ كُلَّهَا تُكْفِرُ اللِّسَانَ فَعَمَلُ: اتَّقِ اللَّهَ فِينَا فَإِنَّمَا نَحْنُ بِكَ، فَإِنِ اسْتَقَمَّتْ اسْتَقَمْنَا وَإِنِ اعْوَجَجَتْ اعْوَجَجْنَا.

*“Për çdo ditë në mëngjes kur zgjohet njeriu të gjitha organet ia tërheqin vërejtjen gjuhës duke i thënë: ‘Ki frikë All-llahu për ne! Pa dyshim që ne të ndjekim ty. Në qoftë se ti do të jesh e drejtë, edhe ne do të jemi të drejtë. Në qoftë se ti lakon dhe bën mëkat, edhe ne do të lakojmë e do të bëjmë mëkat”.*¹³

Nuk ka gjë më të natyrshme sesa fjalën më të drejtë ta ketë thënë ai që ishte gojëtari më i mirë, që fjalën më të thukët ta ketë shprehur njeriu më i përkryer, siç ishte Muhammedi a.s. Në suksesin e tij, krahas mbështetjes së Zotit, rol përcaktues ka luajtur edhe sjellja e tij e mirë dhe të folurit e tij e butë. Në Kur’an thuhet:

فَبِمَا رَحْمَةٍ مِنَ اللَّهِ لِنْتَ لَهُمْ وَلَوْ كُنْتَ فَظًّا غَلِيظَ الْقَلْبِ لَانْفَضُّوا مِنْ حَوْلِكَ ...

“Në saje të mëshirës së Perëndisë, u sollë butësisht me ta (o Muhammed!) – e sikur të ishe i ashpër dhe vrazhdë, ata do të largoheshin prej teje...” (Alu Imran, 3:159).

Burimi i fjalës

Kur ne njerëzit flasim, përdorim fjalët që kanë fituar kuptim nga trashëgimia kulturore e nënvetëdijes kolektive duke ua përshtatur preferencave tona të vetëdijshme ose të pavetëdijshme të nënvetëdijes sonë personale për të shprehur një kuptim ose deklaratë që përshtatet me dëshirën tonë në momentin kur flasim. Vetëdija jonë përbën terrenin konceptual të asaj që ka bërë vend në nënvetëdijen tonë, sipas fjalëve të Junk-ut përbën “shtëpinë e ekzistencës” së gjuhës. Adleri pohon se gjuha ka lidhje të ngushtë me nënvetëdijen kolektive dhe se me veçoritë e saj të përgjithshme ajo është një produkt i jetës shoqërore dhe me këtë ajo i mbërthen njerëzit.¹⁴ Kuptimin dhe natyrën e një gjëje e përcaktojnë njohuritë e përjetuara eksperimentale, besimet dhe vlerat që besohet se kanë shenjtërinë e tyre si dhe gjendjet psiko-

¹¹ Buhariu, Edeb, 1997.

¹² Buhariu, Iman, 5.

¹³ Tirmidhiu, Zuhd, 60.

¹⁴ Alfred Adler, *İnsanı Tanıma Sanatı* (përkthim i veprës Understanding Human Nature), Stamboll 1997, f. 48.

sociale të njerëzve në momentin kur flasin. Njohuritë eksperimentale dhe besimet, meqë përcillen nga brezi në brez si një trashëgimi kulturore, ato kanë edhe veçori historike.

Njeriu si një qenie e aftë për t'i simbolizuar gjërat, ndjenjat dhe mendimet, me fjalët dhe emrat që ua vë sendeve dhe veprimeve, ai e krijon gjuhën, e zhvillon shkrimin dhe ua përcjell brezave të ardhshëm përvojat e tij. Nga kjo analizë psiko-kulturore kuptojmë se fjala ka dy burime: nga njëra anë burimin kulturor nga aspekti i hapësirës kuptimore që ka fjala dhe nga ana tjetër burimin emocional nga aspekti i rizierjes në zemrën – ose në mendjen – e njeriut dhe që atij pastaj i shërbehet si një gosti. Proverbi kinez në vazhdim, i cili shumë mirë e shpreh ndikimin psikologjik të fjalës, i emocionon tej mase ata që e dëgjojnë për herë të parë: *“Një fjalë që shkëputet nga zemra mjafton për ta ngrohur njeriun tre dimra”*. Një fjalë shumë e ngrohtë që ia ngroh njeriut brendinë e tij. Njeriu pajtohet për një fjalë që do ta ngrohë jo për tre dimra, por edhe për tre muaj bile. Një njeri që e di vlerën e fjalës, nuk do të kursejë asgjë për ta dëgjuar një fjalë miku që në pranverë t'i njomë shpresat, në verë të freskon, në vjeshtë të çlodh dhe në dimër të ngrohë.

Fuqia e fjalës

Fuqia e fjalës është në përpjesëtim të ngushtë me fuqinë, autoritetin dhe namin që ka folësi. Në qoftë se një njeri i panjohur flet fjalë të urta, të mençura, me shumë gjasë ai nuk do t'ia tërheqë vëmendjen askujt dhe bart vlerën neutrale, e cila ekzistencën e ka të barabartë me jo-ekzistencën, si një ar i pazbuluar. Ndërkaq kur nga goja e një njeriu të famshëm dhe me autoritet del një fjalë shumë e thjeshtë bile, masat për të do të diskutojnë me ditë të tëra dhe nga ajo do të nxjerrin kuptime që as edhe folësit nuk do t'i kishte vajtur mendja kurrë. Fuqinë e fjalës besoj se nuk e shpreh diçka tjetër më mirë sesa ky katërvargësh i Junus Emres:

*Söz ola kese savaşı
söz ola bitire başı
Söz ola ağılı aşı
bal ile yağ ede bir söz*

Ka fjalë që e ndalin luftën,
ka fjalë që ta humbin kokën
ka fjalë që ushqimin e helmuar
fjalë që ta bëjnë mjaltë dhe vaj

Fjala që del nga goja i ngjanë shigjetës që del nga harku. Kthimi mbrapsht është i pamundshëm. Ka fjalë që njeriun e vejnë *vezir* (ministër), ka fjalë që njeriun e bëjnë *rezil* (të nënçmuar). Ka fjalë që njeriut ia hapin shumë porta, po ka fjalë që njeriun e fusin në belara. Edhe ky dyvargësh i M. Akif Ersojit flet për peshën dhe fuqinë që mund të ketë fjala:

*Dilimden olur bana her ne olursa
Dîlim rahat olur dilim durursa.*

Nga gjuha e kam, gjithçka që më bën vaki
Zemrën e kam të qetë, nëse më ndalet gjuha

Gjatë gjithë historisë, njerëzit kanë folur fjalë me vend e pavend aq sa nuk i kap lapsi, mirëpo prej të gjitha këtyre te ne janë përcjellë si një trashëgimi kulturore një numër i vogël, pikërisht ato që kanë pasur fuqi dhe ndikim të madh. Prej fjalëve të regjistruara, që kanë pasur mundësi të mbijetojnë dhe ta ruajnë fuqinë, duhet pranuar se janë tejet-tejet më të shumta, sesa ato që kanë ngelur aty ku janë thënë.

Parimet e të folurit

Edhe fjalët më të bukura bile mund të bëhen të mërzitshme dhe të neveritshme në qoftë se dalin nga goja e një të trashi. Të përdorësh një metodë të bukur, fjalën e mirë e të bukur ta thuash në vendin e drejtë, është po aq e rëndësishme sa edhe drejtësia dhe bukuria vetë e fjalës. Për këtë arsye, kur të flasim duhet t'u përmbahemi parimeve në vijim:

- 1 - Të folurit duhet të bëhet për të siguruar një dobi ose për të larguar një dëm, madje edhe në bisedat e thjeshta duhet pasur kujdes që të arrihen rezultate të dobishme.
- 2 - Tema e bisedës duhet zgjedhur sipas interesimit, dijës dhe nivelit të dëgjuesit.
- 3 - Duhet shikuar nëse rrethanat, njerëzit dhe koha janë të përshtatshme për të folur.
- 4 - Duhet folur me një ton të cilin do të mund ta dëgjojë dëgjuesi. Kur'ani fisnik lidhur me këtë thotë: *"Ec me kujdes e modesti, e fol me zë të ulët; se zëri më i vrazhdë është zëri (pallja e) i gomarit!"* (Lukman, 31:19).
- 5 - Së pari duhet dëgjuar ajo që flitet, duhet kuptuar tema e saj, e pastaj në qoftë se nevojitet duhet folur vetëm aq sa ka nevojë. Lidhur me edukatën e të folurit ka disa fjalë të urta:
Zoti të ka dhënë dy veshë e një gjuhë, që të dëgjosh dy herë e të flasësh një.
Në qoftë se fjala është e argjendtë, heshtja është e artë.
Njerëzit e përkryer shkallën e tyre e kanë arritur përmes heshtjes.
Ai që flet shumë, pandeh se i dëgjohet fjala. Nuk e kupton se dëgjuesit i mërzit.
- 6 - Pa mos u dhënë shumë pas personave dhe ngjarjeve, duhet përpjekur të kuptohet tema kryesore e ngjarjes, lidhja shkak-pasojë e saj. Proverbi kinez në vijim e shpreh shumë qartë rëndësinë e ruajtjes së nivelit gjatë bisedës:
Kokot e mëdha flasin për mendimet, kokat e mesme flasin për ngjarjet, kurse kokat e vogla flasin për personat.
Të flasësh për personat mund të shkaktojë thashetheme, kurse të merresh me rrëfimin e ngjarjes rrezikon ta humbasësh pikën kyçe të vetë ngjarjes.
- 7 - Edhe kur flet edhe kur dëgjon, tjetrin duhet shikuar në fytyrë. Gjestet dhe mimika ndërkaq duhen përshtatur rrjedhës së temës. Në qoftë se gjatë bisedës me dikë shikon pa nevojë andej-kënde, ose shikon televizion, ose shfleton një libër a gazetë, të gjitha këto tregojnë se je i mërzitur dhe se nuk dëshiron ta dëgjosh bashkëbiseduesin tënd. Është zotësi të dish të dëgjosh.
- 8 - Nuk duhet prerë bisedën tjetrit dhe pa mbaruar biseda e pa marrë leje nuk është mirë të lëshohet kuvendi.
- 9 - Gjatë bisedës assesi nuk duhet dhënë mundësi rrenës dhe njohurive mashtruese. Tema e diçkaje nuk duhet bartur në mënyrë të cunguar apo të tepruar.
- 10 - Duhet përzgjedhur mirë fjalët që do të përdorim. Duhet pasur kujdes që të mos i ofendojmë njerëzit dhe të mos i keqpërdorim ndjenjat e tyre duke i kruar temat e panevojshme e delikate.

All-llahu xh.sh. u ka dhënë sihariq atyre që dinë të dëgjojnë dhe që përdorin fjalët më të mira e më të bukura:

وَالَّذِينَ اجْتَنَبُوا الطَّاغُوتَ أَنْ يَعْبُدُوهَا وَأَنَابُوا إِلَى اللَّهِ لَهُمُ الْبُشْرَىٰ فَبَشِّرْ عِبَادِ ﴿١٧﴾ الَّذِينَ يَسْتَمِعُونَ الْقَوْلَ فَيَتَّبِعُونَ أَحْسَنَهُ أُولَٰئِكَ الَّذِينَ هَدَاهُمُ اللَّهُ وَأُولَٰئِكَ هُمُ الْأُولَاءُ ﴿١٨﴾

“Ndërkaq, ata që u larguan prej adhurimit të idhujve dhe ju drejtuan All-llahut, ata kanë gëzim të madh, e ti përgëzoji robërit e Mi! Të cilët i dëgjojnë fjalët dhe pasojnë atë më të mirën prej tyre. Të tillët janë ata që All-llahu i udhëzoi në rrugën e drejtë dhe të tillët janë ata të mençurit.” (ez-Zumer, 39:17-18)

Thuhet se “kafshët kuptohen duke nuhatur, ndërkaq njerëzit duke biseduar”. Në qoftë se i shikojmë diskutimet që bëhen, zënkat dhe mospajtimet që shfaqen, do të kuptojmë lehtë se njerëzit akoma nuk janë mësuar të flasin si duhet. Në të shumtën e rasteve shkak i zënkave janë fjalët e pamatura, me të shara e me mungesë respekti. Nga ana tjetër, fjalët e mira e të bukura të thëna në kohën dhe vendin e duhur kanë qenë pikënisja e lumturive më të mëdha që i ka njohur njerëzimi.

Nga turqishtja:
Rejhan Neziri